



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

NJESIA E PROKURIMIT

Dibër, më 01.09.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: Rehabilitim Sistemim Asfaltim i rrugeve se fshatrave Herbel ,
Grezhdan dhe Voinik**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Pune ndertimi
(45000000-7).**

VLERA E FONDIT LIMIT: 11.666.666,67 (njembedhjetë milion e gjashtëqind e gjashtedhjetë
e gjashtëmijë e gjashtëqind e gjashtedhjetë e gjashtë presje gjashtedhjetë e shtatë) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe
nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit
publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Diber ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe
miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me
përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:
 - a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;
 - b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas percaktimeve të bera në Shtojcën 7 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (**2022,2023,2024**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika “c”, e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizën e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë të percaktuara në aktmarreveshje.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislativës të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuara nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2022,2023,2024**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës ose lotit që prokurohet.

Kjo pikë konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 si dhe kestet e maturuara për vitin 2025 prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Shënim: Per kete pike 2.2.3 te mesiperme operoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

2.3.2 Staf i kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar për këto punime.

a) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:

- | | |
|-----------------------------------|---------|
| 1. Inxhinier Nderimi | 1 (nje) |
| 2. Inxhinier Topograf ose Gjeodet | 1 (nje) |

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën periudhën **3-mujorin e fundit**. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune noteriaale (e vlefshme).

b) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij personel të kualifikuar/certifikuar si:

- 1 (një) punonjes përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, i cili të jetë i certifikuar **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e ligjit nr.10327 datë 18.02.2010 *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”* dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 *“Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”*.

Shenim: Për këten pikë 2.3.2 a) dhe b) të mesipërme operatorët ekonomik në fazën e ofertimit duhet të paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zërat dhe vëllimet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është përlogaritur në një kohë të shkurtër i cili kërkon fuqi punëtore të shtuar dhe me mjetet e kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë fuqi minimale punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me një numër prej mesatarisht **20 (Njëzet) punonjës.**

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **3-mujorin e fundit**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **3-mujorin e fundit**.

Shenim: Per kete pike 2.3.3 te mesiperme operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punetore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlllogaritur në një kohë të shkurtër i cili kërkon fuqi punetore të shtuar dhe me mjetet e kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij specialistë të certifikuar sipas profesioneve, të pakten si më poshtë:

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **2 (dy)** punonjës **manovratorë** të, për të cilët duhet të paraqesë kontratë individuale pune të vlefshme, Dëshmi Aftesie Profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet perkatese, dëshmi të sigurimit teknik (të vlefshme) , si dhe të figurojnë në lispagesat e shoqërisë për të pakten muajin e fundit.
- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **1 (një)** punonjës **automakinist** të, për të cilët duhet të paraqesë kontratë individuale pune të vlefshme, Dëshmi Aftesie Profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet perkatese, dëshmi të sigurimit teknik (të vlefshme) , si dhe të figurojnë në lispagesat e shoqërisë për të pakten muajin e fundit.
- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **2 (dy)** punonjës **shoferë** , për të cilët duhet të paraqesë kontratë individuale pune të vlefshme, Dëshmi Aftesie Profesionale (të vlefshme), dëshmi të sigurimit teknik (të vlefshme), lëshuar nga

institucionet perkatese, si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten muajin e fundit.

- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht **1 (nje)** teknik ndertimi , per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, diplome, deshmi te sigurimit teknik (te vlefshme), si dhe te figurojne ne lispagesat e shoqerise për të pakten periudhën si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise për të pakten muajin e fundit.

Shenim: Per kete pike 2.3.4 te mesiperme operatoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e ketij kriteri per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perllogaritur ne nje kohe te shkurter i cili kerkon fuqi punetore te shtuar dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate.

2.3.5 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmoje se dispononë liçense profesionale për zbatim punimesh në ndertim, duke perfshire kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar.

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

N.P-1 A (Punime gjurmimi në tokë)

N.P-4 A (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale)

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme.

N.S -6 A (Sinjalistika rrugore jo ndricuese).

N.S – 18 A (Punime topogjeodezike).

- sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI;

Për operatorët e huaj të bëhet njëhësimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të liçencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (*njehsimin*) e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë kompetente të ngarkuar me ligj në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit bashkëngjitur në SPE.

2.3.6 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të përthyerat në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- SSH/EN/ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë (të vlefshme) “ose ekuivalent;
- SSH/EN/ ISO 45001-2018 mbi “Sistemin e menaxhimit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalent;
- SSH/EN/ISO 39001 :2012 mbi “Sistemi i Menaxhimit të Trafikut Rrugor” ose ekuivalent;

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.7 Operatoret ekonomik duhet të paraqesin mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si me poshtë (shtojces 8):

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
----	--------------------	----------	-------

1	Kamiona vetshkarkues kap. mbajtes mbi 8 ton	në pronësi ose me qira	Cope 2
2	Kamioncina me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Cope 2
3	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Rrul ngjeshes gome - cilinder me kapacitet min 10 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Fabrike asfalti-betoni e pajisur me leje mjedisore	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi	Copë 1
6	Nyje thyerje materiale inerte e pajisur me leje mjedisore	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi	Cope1
7	Eskavator me zinxhir	Ne pronesi ose me qera	Cope 1
8	Autobitumatriçe	Ne pronesi ose me qera	Cope 1
9	Asfalto-shtrues	Ne pronesi ose me qera	Cope 1
10	Makineri vijezimi	Ne pronesi ose me qera	Cope 1
11	Rrul asfalti cilinder - cilinder me kapacitet min 8 ton	Ne pronesi ose me qera	Cope 1
12	Grejder	Ne pronesi ose me qera	Cope 1

Operatorët ekonomik që disponojnë kontratë furnizimi për Fabrike asfalti-betoni e pajisur dhe Nyje thyerje materiale inerte, leja mjedisore u kërkojnë personave të tretë, që nuk janë konkurrent në këtë procedurë prokurimi.

Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion pajisjet teknike (pronesi ose me qera), të nevojshme për ekzekutimin e kontratës si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit):

- Kokore, minimumi 20 copë.
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 5 copë.
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi, 3 copë.
- Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi 5 copë.
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi, 5 copë.

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikatën e pronësisë së mjetit.

- b)** Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontratën perkatese noteriale të qerases, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- c)** Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- d)** Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre.
- e)** Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- f)** Makinat e transportit të shoqërohen gjithashtu edhe me Leje të Transportit të Mallrave (të vlefshme), leshuar nga organet kompetente në emër të shoqërisë apo subjektit pronar të mjetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- g)** Mjeti autobitumatriçe të shoqërohet me Leje të Transportit të Mallrave të rezikshme (të vlefshme), leshuar nga organet kompetente në emër të shoqërisë apo subjektit pronar të mjetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- h)** Makineritë e deklaruar në këto kontrate nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera në autoritetin tone

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Shenim: *Per kete pike 2.3.7 të mesiperme operatorët ekonomik në fazën e ofertimit duhet të paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojcës nr.8.*

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialisti i fushës.

2.3.8. Grafiku i punimeve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga projektuesi, bashkëngjitur DST në SPE.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Njesia e prokurimit: